



Save the Children



# Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës sipas fëmijëve

Album

*Ky botim u realizua në bashkëpunim me nxënësit përfaqësues të qeverisë së nxënësve në shkollat ku Save the Children zbaton projektet e tij. Ai do të përdoret nga ata për të informuar nxënësit e tjerë të cilët ndjekin shkollën në ciklet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe të lartë për nenet 33; 34; 36 dhe 63 të ligjit të ri të arsimit parauniversitar që lidhen me qeverinë e nxënësve; bordin e shkollës; komisionin e sjelljes dhe etikës; dhe arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjithashtu do të përdoret për të promovuar të drejtën e fëmijëve për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.*

*Mirënjohje te veçantë përfaqësuesve të qeverive të nxënësve, përkatësisht Shkolla Demir Gashi Peshkopi; Shkolla Ali Metra Burrel; Shkolla 3 I Korriku Burrel; Shkolla Fadil Gurmani Elbasan; Shkolla Asdreni Korçë Shkolla Agimi Korçë; Shkolla A.Z. Çajupi Gjirokastrë Shkolla Njazi Mastori Durrës; Shkolla Avni Rustemi Vlorë; për ndihmën e çmuar dhe sugjerimet e tyre në lidhje me shkrimin e neneve në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.*

Ky botim u mbështet nga Save the Children.

### **Save the Children**

Rr "Komuna e Parisit" Lagjia 8, Pallatet I Maji, Vila "Lami" P.O. Box 8185, Tirane - Albania

Tel: +355 4 2261840/+355 4 2261929/+355 4 2266227; Fax: +355 4 2263428

Email: [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org);

Web Page: [albania.savethechildren.net](http://albania.savethechildren.net)

TIRANË, 2014

Ky botim publikohet në kuadër të projektit "Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës" të organizatës Save the Children

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të arsimit apo mësuesve për zhvillim praktikash të mira, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e Save the Children si burim.

Këndvështrimet e fëmijëve si autorë të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children

**Nxënësit:**

1. Arlind Shehu
2. Ada Truka
3. Marsida Hysa
4. Serxho Metra
5. Eralda Likcani
6. Redi Dani
7. Andi Meta
8. Inejda Pali
9. Emanuela Koçi
10. Rexhina Alla
11. Brisilda Karafilii
12. Kriselda Suqe
13. Enkelejda Leskoviku
14. Ervina Tusha
15. Zamira Dono
16. Seira Kuti
17. Najada Shkalla
18. Krisi Bejko
19. Denis Mane
20. Eldi Bicari
21. Kledia Shkëlqimi
22. Ina Bregu
23. Ariela Zeneli
24. Elionos Kasaj
25. Ledina Ilasllani
26. Lorena Mehdi

**Mësueset përgjegjëse për qeverinë e nxënësve:**

1. Adela Puca
2. Marseliana Kasaj
3. Aida Bejko
4. Atlie Palamani
5. Donika Nakollofski
6. Entela Petro
7. Shero Bedaj
8. Aurora Keraj

**Koordinoi dhe lehtësoi procesin**

Emë Kasapi

## Thënie të fëmijëve

### Si e kuptojnë fëmijët ligjin

#### Çfarë është ligji?

- Ligji është rregull i shkruar për të cilin moszbatimi ndëshkohet
- Ligji është detyrim për çdo qytetar kudo që ndodhet
- Rregull në funksionim e shoqërisë
- I shkruar dhe i miratuar
- Stabilizator i demokracisë
- Të gjithë të barabartë përpara ligjit
- Të gjithë duhet të njohim mirë ligjin, mosnjohja e ligjit sjell moszbatim
- Detyrim ligjor që e bën shtetin të funksionojë sipas ligjeve

#### Përse duhet ligji dhe kush i bën ligjet dhe përse na shërbejnë?

- I harton parlamenti;
- Sistemi qeverisë;
- Populli nëpërmejet përfaqësuesve të tij
- Vendoset nga njerzit dhe miratohen nga parlamenti
- Për nevojat që shoqëria ka
- Për të shfrytëzuar burimet që vendi ka

#### Çfarë ndodh kur ligji nuk zbatohet?

- Krijohet kaos – rrëmujë
- Shoqëria dhe shteti nuk funksionon siç duhet
- Moszbatimi i ligjit sjell moszhvillimin e shoqërisë
- Prapambetje në zhvillimin e shoqërisë dhe shoqëria nuk ecën me hapin e kohës
- Cënohen të drejtat nëse nuk respektohet ligji
- Shkak për luftë, rritet kriminaliteti
- Shoqëria është përgjegjëse për zbatimin e ligjit
- Bota pa ligje është si pema pa gjethe dhe fruta

### **Kur bëjmë ligje të reja?**

- Kur ligji nuk është në favor të njerëzve
- kur ligji ekzistues cënon të drejtat
- kur ligji nuk i mbron të gjithë në mënyrë të barabartë
- kur shkakton diskriminim
- kur nuk ndihmon në emancipimin e shoqërisë
- kur cënohet demokracia
- pengon funksionimin e shoqërisë
- Pavarësinë e sistemit gjyqësor
- Cënohet integrimi i vendit

### **Kush e harton ligjin për arsimin?**

- mësuesit
- prindërit dhe komuniteti
- nxënësit dhe qeveria nxënësve
- ligjvënësit
- organizatat për mbrojtjen e fëmijëve
- shkollat dhe drejtoria arsimore
- ministria e arsimit

### **Pse duhet njohur dhe zbatuar ligji për arsimin?**

- Njohja sjell eksperiencë dhe njohuri
- Sjell ndryshim
- Do të ndihmojë në përmirësimin e shkollës
- Sepse jemi ne ata që do ta zbatojmë
- Do të plotësohet e drejta e fëmijëve për arsim
- Do të influencojnë në edukimin tonë
- Është më i thjeshtë zbatimi
- Ndihmojnë në zhvillim
- Më e lehtë për tu kuptuar dhe zbatuar nëse do të jetë në gjuhë fëmimore

# Nene të ligjit parauniversitar të shkruara në gjuhë fëminore

## Neni 36

### Qeveria e nxënësve

1. Të përzgjedhurit nga klasa janë një grup fëmijësh që ndjekin shkollën të cilët mbrojnë dhe ndihmojnë në zhvillimin e të drejtave të nxënësve dhe ndihmon në vajtjen mbarë të shkollës. Ajo ngrihet dhe funksionon sipas, shpjegimit të ministrit (drejtues i ministrisë së arsimit).
2. Përfaqësuesi i qeverisë së nxënësve nga klasa 5 deri në klasën 9 zgjidhet nga nxënësit me votë të drejtëpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Grupi i nxënësve të përzgjedhur – qeveria e nxënësve përzgjedh mësuesin me të cilin do të bashkëpunojnë.
4. Në shkollë funksionojnë dhe grupime të tjera të nxënësve të ngritura për përfitimin e njohurive në shkencë kulturë dhe sport.

## Neni 34

### Bordi i shkollës

#### Grup njerzish të zgjedhur që të marrin vendime për shkollën

1. Cdo shkollë ka një grup të përzgjedhur individësh i përbërë nga prindër, nxënës, mësues dhe të zgjedhurit e komunës ose bashkisë dhe komunitetit. Ky grup ndihmon për mbarëvajtjen e shkollës dhe e tregon aktivitetin e tij tek prindërit e zgjedhur
2. Detyra kryesore e këtij grupi janë :
  - a. bie dakord për planin 4 vjeçar dhe vjetor të shkollës;
  - b. bije dakord për planin e shpenzimeve të shkollës, për të ardhurat të cilat sigurohen nga shkolla;
  - c. bije dakord për tërësinë e veprimeve që ndodhin brenda shkollës
  - d. merr pjesë në përzgjedhjen apo largimin e mësueseve ose drejtorit të shkollës

3. Përbërja e grupit, të drejtat dhe detyrat pjestarëve të grupit (bordit), dhe mënyrat e zgjedhjes së tyre përcaktohen nga ministri i arsimit.

### **Neni 33**

#### **Komisioni i etikës dhe sjelles ose grup njerzish të cilët zgjidhen me anë të votimeve në institucionet arsimore për rregullat e sjelljes**

Në shkollë funksionon grupi i njerzve të caktuar që janë zgjedhur me anë të votës i përbërë nga mësues, prindër dhe nxënës. Ky grup ka për detyrë të verifikojë shqetësimet e nxënësve, prindërve dhe të punonjësve të shkollës ndaj shkeljeve të rregullave kryesore të sjelljes, dhe ti sugjerojë drejtorit të shkollës veprimet që duhen të merren për të parandaluar dhe përmirësuar gjendjen.

### **Neni 63**

#### **Arsimi i fëmijëve me aftësi të tjera dhe paaftësi për të kryer një veprimtari të caktuar**

1. Arsimi i fëmijëve me aftësi të tjera dhe paaftësi për të kryer një veprimtari të caktuar ka për qëllim zhvillimin e plotë të vlerave arsimore dhe fizike të tyre dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, për t'i përgatitur për zhvillim të plotë në shoqëri dhe në vendet e punës.
2. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të tjera dhe paaftësi për të kryer një veprimtari të caktuar në shkolla të veçanta për ta është e përkohshme. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të tjera dhe paaftësi për të kryer e një veprimtari të caktuar në kopshte dhe shkolla të arsimit bazë është kryesore.
3. Nxënësve që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin u sigurohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë ju sigurohet përdorimi i shkrimit për të verbrit - me prekje.

*Ese dhe punime grafike të përgatitura nga fëmijët e grupit Zëri 16 + Elbasan dhe Durrës. Grafika të përgatitura nga fëmijë në kontakt me ligjin në Tiranë, Vlorë, Korçë, Kavajë dhe Lezhë.*

## **Mësuesi ideal. Si e dua unë shkollën time Krijime të fëmijeve në kuadër të Javës Globale të Edukimit**

### **I dashur mësues**

Unë jam Eri, Ana, Alma, por jam edhe Beni, dhe Lulja, dhe... çdo nxënës. Po ju shkruaj për këto që na ndodhin çdo ditë në bankat e shkollës. Ndoshta juve do t'ju vijë çudi dhe do të pyesni: Po përse mua?

Dhe unë do t'ju përgjigjem.

Një ditë unë u godita me libër në fytyrë, sepse nuk kisha mbyllur librin gjatë shpjegimit të mësuesit. Që atë ditë u bëra më “e zgjuar”.

Në provimin e lëndës së fizikës kishte shumë pyetje dhe për kohën e kufizuar që kishim në dispozicion nuk e realizuam dot. Kujt i shërbeu kjo...?

Një shoqja ime e klasës është nga fshati, sa herë që ngrihet në dërrasë një mësuese e lëndës X e ironizon.

A është i drejtë përdorimi i dhunës fizike dhe psikologjike mbi mua, kur un thyej rregullat? Unë pres nga ju të gjeni mënyra të reja për të më edukuar dhe bindur kur unë jam gabim.

Në provimin e Gjeografisë unë dhe Zana morëm notën 7, por në regjistër në vend të 7 Zana kishte një 10. A është e drejtë kjo?



Mësuesi i matematikës kërkon më tepër se çfarë ai shpjegon. A jam i detyruar të ndjek kurset private që ky mësues ofron, apo të pranoj vlerësimin e ulët që pa të drejtë unë marr?

Mendoj, që mësuesi nuk duhet ta përdorë notën për të fituar autoritetin e tij në klasë.

A e kuptoni tani se nga e morra guximin që tju shkruaj? Ju jeni mësuesi im ideal dhe nuk dua të përjetoj as unë as shokët e mi të tilla gjëra dhe nga JU.

Edukimi është ai që bën dallimin mes individëve. Ju jeni porta ime drejt dijes dhe të ardhmes time si një individ i qytetëruar, i të ardhmes që pretendojmë të krijojmë. Ndoshta prindi edukon një fëmijë, por ju edukoni të gjithë shoqërinë prandaj ju jeni më tepër se aq. Ju jeni ai që duhet të më bëjë të mendoj dhe të reflektoj për atë ç'ka jam dhe dua të jem. Unë dhe Ne të gjithë kemi nevojë për Ju që të ndërtojmë të ardhmen e ndritur që të gjithë kërkojmë.

Ashtu si dikur pëllumbi lajmëtar, do të trokas në dyert e të gjithë mësuesëve në botë, për t'ju treguar dhe kërkuar që dhe ata duhet të jenë mësuesi ideal.



# Mësuësi: im IDEAL



PER NUA MËSUËSI IDEAL  
ËSHTE A MËSUËS DE  
SHKON PËRTEJ PROFESIONIT  
DHE KËRHEJT NE NËL PRIND, TE  
DYTE DURE I OERUAR NIKENËSIT

GIITHJONË MBËSHKËTËJE, MBROHTESI DHE DASHUR!

Ujë mësuës ~~konstruktiv~~

## Mësuësi tradicional

- Mësuësi tradicional shpesh pak (momentet që arrijmë detyrë dhe të mëdha të problemeve)
- Mësuësi tradicional detyrë pak (problemet/shpërndarë dhe funksionet dhe detyrat)
- Mësuësi tradicional shpesh shkurorë (mësuësi shpërndarë, shpesh shpesh shkurorë dhe uel interesi dhe funksionet më të mëdha)



## Mësuësi bashkohor

- Mësuësi bashkohor shpesh shkurorë (a mundohet të shpesh situatën dhe problemet dhe mëson më)
- Mësuësi bashkohor detyrë shkurorë (a detyrë shpërndarë dhe të detyrë funksionet të shkurorë dhe të bërë të mëdha të respektuar e c. funksionet me klasë dhe me mëson më)
- Mësuësi bashkohor shpesh pak (mësuësi shpesh pak më funksionet që a mundohet të shpesh mëson më dhe funksionet më të mëdha të shkurorë dhe të mëdha të shkurorë)

Përfundim: Enxhi Ferhati, Ziri K. Elbasan



Shkolla për nxënësit është ambjenti ku kalojnë pothuajse pjesën më të madhe të kohës. Në shkollë janë mësuesit ata që i mësojnë dhe i edukojnë nxënësit. Të qenit mësues nuk është e thjeshtë.

Në një farë mënyre mësuesit kanë në dorë të ardhmen duke patur në dorë gjeneratën e re.

Profesioni i mësuesit ka shumë përgjegjësi pasi çdo veprim i tij ndikon në formimin e nxënësit në çdo aspekt.

Me mësues ideal unë nuk kuptoj vetëm kualifikimin e tij në një lëndë të caktuar dhe aftësinë e tij për ta shpjeguar atë, sigurisht që një mësues ideal duhet ti ketë këto cilësi, por jo vetëm.

Që të quhet i tillë një mësues duhet të jetë i aftë të kuptojë psikologjinë e nxënësit e ta ndihmojë atë në çdo rast.

Ai nuk përdor asnjë lloj dhune apo diskriminimi ndaj nxënësve.

Me anë të fjalëve të tij ai e bën nxënësin të kuptojë dhe të reflektojë për çfarë bën.

Për një mësues ideal nuk ka kurrë mendime të gabuara.

Ai di ta vlerësojë çdo mendim të tij dhe ta motivojë nxënësin të kërkojë më shumë nga vetja.

Por që një mësues ideal të ketë të gjitha këto, duhet që profesionin e tij ta ndiejë dhe çdo veprim e këshillë ta japë me zemër.

Megjithatë asnjëherë nuk do të ketë mësues ideal nëse nuk ka nxënësit ideal.

TËMIJËT VIJNË NË JETË TË PAFORTISHËM E TË TRAPTË ; ATA S'MUND TË ZHYVILLOHEN YËTË,  
PA NDIMHËN E NJË MËSUESI TË PËRKUSHTUAR, TË NDJESHËM DHE ME ZEMRËN E NJË MËNJE.



NJË MËSUES "IDEAL" E NDJEK  
NXËNËSIN HAP PAS HAPIT!

NEBENEFIT



Punoi:  
**Sara Muça**

## **Ne ecim përpara me rrjedhën e kohës. Ese: Mësuesi im ideal**

Mësuesi është pasqyra e edukimit dhe e nisjes së një stadi të ri në jetë i cili kalohet nëpër shumë cikle.

Shembulli i parë i jetës vjen që nga edukatori i cili ndiqet hap pas hapi e më pas nga mësuesi i filltores i cili përforcon vlerat morale të një shoqërie.

Mësuesi ideal është i veshur me ideale të larta edukimi e principe të vlefshme për jetën.

Megjithatë në ditët e sotme ky mësues ideal është zhvlerësuar nga tregues të ndryshëm që vijnë si pasojë edhe e zhvillimit të vendit.

Mbaj mend që në klasë të pare isha shumë e përqëndruar tek mësuesja ime. E dëgjoja me vëmendje dhe fiksoja çdo fjalë të saj. Kur shkoja në shtëpi ua përcillja edhe prindërve të mi se sa besim kisha tek ajo dhe sa shumë e admiroja punën e saj. Madje isha e bindur se do të ndiqja hapat e saj duke u bërë edhe unë një arsimtare në një të ardhme.

Që në atë moment e kuptova se mësuesi është një faktor shumë i rëndësishëm në jetë.

Arsimimi është bërthama e një jetë normale e të shëndetshme, e ai duhet të merret nga persona të denjë.

Me kalimin e viteve në stadet më të larta të shkollimit tim kuptova se mësuesi ideal nuk ishte ai i klasës së parë fillore po ishte krejt ndryshe... Kështu mësova se nuk egzistonte një i tillë, edhe ata që ishin, ishin shumë të paktë në numër ose bëheshin pjesë e rrjedhës të detyruar nga faktorë të ndryshëm.

Sot mësuesi ideal për mua nuk egziston, ai mbetet pjesë e fëmijërisë time.

Një mësues i sotëm është kthyer në një person formal thjesht mban titullin “mësues” i veshur me një përparëse të bardhë, por nuk arrin ta justifikojë këtë titull.

Në këto kushte edhe marrëdhëniet mësues-nxënës ndryshojnë, ftohen e këto janë shkaqe të konflikteve të ndryshme në mjediset e shkollave.

Ne nxënësit kemi mësuar ta ngrejmë zërin tonë fuqishëm por në raste kur jemi të presionuar nga ulja e notës apo diçka tjetër kjo është e pamundur.

Kështu çdo gjë duket sikur shkon mirë por në fakt çdo njeri ka nevojë për një mësues ideal që të jetë jo vetëm dijedhënës por të ketë aftësinë të komunikojë me nxënësit për probleme të ndryshme sepse në shkollë mësohet edhe sjellja e duhur pa u imponuar.

Kështu ka edhe një pjesëmarrje të konsiderueshme nxënësish në bankat e shkollave duke e dëgjuar me interes mësimin.


Mësuesi ideal është në mendjet e shumë nxënësve duke e veshur me karakteristika tepër të mira por nuk egziston pasi edhe vetë bota ideale nuk egziston e mes gjithë këtyre sjelljeve në dukje të mira por që shprehin shumë vlera të ulëta duket se ne ecim përpara me rrjedhën e kohës.

Një mësues ideal është ai që  
hyn në botën e fëmijëve dhe  
formon një  
njeri të aftë  
për shoqërinë.



GEMAL ÇIFTJA

Zëri 16+...



Punoi: **Marjo Metaj**



Punoi:  
**Elda Kushi**  
Zeri 16+ Elbasan

## Ese: “Mësuesi im ideal.”

Në ditët e sotme, shpesh na ndodh që të krijojmë raporte të reja në shoqëri por edhe të ruajme atë që ne kemi krijuar më parë. Miqësitë ndodhin së tepërmi brenda shkollës, afërsia nxënës-nxënës mirëpo përvec kësaj afërsie është edhe raporti mësues-nxënës i cili evoluon çdo ditë për vetë faktin se mësuesi është ai person që qëndron gati gjysmën e ditës me ne adoleshentët dhe përpiqen të kuptojnë çdo gjellje që shfaqim dhe reagemet tona.

Shkolla si institucion edukon nxënësit dhe jep sa më shumë dije dhe njohuri ku si përbërës të saj janë dhe mësuesit. Duke qenë në kontakt të përditshëm mësuesit shohin se çfarë ne përjetojmë, çfarë problemesh hasim në rrugën ndonjëherë monotone të ditës dhe dashje pa dashje edhe ata bëhen pjesë, përfshihen në jetën tonë dhe ndonjëherë i përjetojnë dhe ata emocionet dhe mundohen të na japin ndonjë zgjidhje të duhur apo të na shpjegojnë rrugën më të mirë për të zgjedhur. E ardhmja varet pikërisht nga kjo mënyra e të të nxënës të rinjve dhe janë pikërisht ata elita e shoqërisë dhe që i japin formë të ardhmes.

Qëndrimi i mësuesit është një faktor që ndikon në realizimin e marrëdhënieve tona me ta. Shumë prej tyre afrohen dhe japn mbështetje ku mund të bazohesh për të ecur përpara (sigurisht vlen shumë të përmendet edhe familja), drejt rrugës së florinjte të dijeve dhe të gjesh një fitore në fund të saj.

Shpesh mësuesi shihet si një figurë standarte që vetëm flet e



flet pambarimisht, si një “kasafortë dijesh”, por harrohet fakti se do të jetë pikërisht ky “personazh i filmit tonë karrierist” pranë nesh.


Një mësues mund të përkufizohet si një “Wikipedia”, ku cdo gjë që mund të gesh ka vlerë, përthithet e trasmetohet nga të gjithë. Mjafton thjesht një klikim për të shtypur butonin e saktë dhe përpara teje do të shfaqen informacionet e kërkuara të nevojshme, që do të thotë se sa herë të nevojiten njohuri të reja për të zgjeruar bagazhin dhe sirtaret e mendimeve, një portë e sigurtë është mësuesi.

Për të kaluar tek eksperiencia ime personale, mund të them se raportet me mësuesit kanë qenë të mira me të gjithë qysh në fillesat e para. Tek disa mësues kam gjetur shumë mbështetje dhe siguri për të cilat kam pasur nevojë.

Një mësues ideal është ai që di të krijojë një relacion me nxënësit adoleshentë dhe mbi të gjitha ta mbajë atë. Kur mësuesi fal, dhuron buzëqeshje, ngrohtësi, mbështetje, dashuri e bëjnë vetë nxënësin të ecë pranë tij dhe të respektohet më shumë duke ia kthyer në një njëjten monedhë. Gjithashtu vlerësohet dhe fakti që mësuesi është i aftë të vlerësojë nga ana psikologjike dhe të kuptojë nxënësin nëpërmjet vështrimeve.

Për mua është e rëndësishme idea se figura e mësuesit ndikon në formimin tonë dhe nëse është një mësues shembull atëherë vlen të ndiqet si i tillë.





Punoi:  
**Sindi Bylyku**

## **Ese argumentuese me temë: “Mësuesi im ideal”**

Në ditët e sotme dhe në të kaluarën, po të shohim me vëmendje zhvillimin e konceptit mbi mësuesin do të vemë re se ky koncept ka ardhur gjithnjë duke u zhvilluar. Konteksti historik e kushtëzon atë duke e mbrytur në kornizat e cdo sistemi qeverisës dhe moral të shoqërisë. Si një përmbledhje të shkurtër mund të themi se mësuesi si figurë, është parë në dy këndvështrime të mëdha lidhur me periudhën historike të cilave i përkasin ; si një figurë vetëm arsimuese në sistemin socialist totalitar; dhe si një figurë mbi të gjitha edukuese në sistemin demokratik.

Një masë e madhe e shoqërisë së sotme mbron faktin se mësuesi duhet të jetë, përveçse një profesionist i mirë në fushën e vet edhe një individ edukues për nxënësit. Ajo cka na bie në sy, është se ky status, në të cilin mësuesi arrin të krijojë marrëdhënie më të afërta me nxënësin, i jep të drejtën atij të thellohet në karakterin e individit nxënës duke zbuluar tipare dhe anë të personalitetit të tij që janë një ndihmë në procesin mësimor. Kjo ndodh për të vetmen arsye, sepse duke e njohur fëmijën apo të riun si një karakter apo duke njohur një problem të jetës së tij private , mënyra e vlerësimit bëhet më e pranueshme nga të dyja palët mësues-nxënës. Në ato raste kur nxënësi karakterizohet nga një natyrë impulsiv apo kur dihet kapaciteti i nxënësit ai do të vlerësohet në mënyrë të drejtë, sepse aty nuk do të ketë vend për kamuflime nga ana e nxënësit në provime apo në testimet me gojë.

Gjithashtu, të qenit afër me fëmijën dhe të trajtuarit e tij me afritet dhe përzemërsi, sidomos kur është në moshë të njomë apo në periudhën e pubertetit, ndikon në marrëdhëniet mësues-nxënës. Një mësues që është i gatshëm ta dëgjojë nxënësin e tij për çfarëdo shqetësimi dhe të përpiqet për ta zgjidhur do të ndikojë pozitivisht tek ai. Përveç familjes, rol edukues mjaftueshëm të rëndësishëm ka edhe shkolla, e cila merr përsipër si institucion shtetëror të nxjerrë nga bankat e saj nxënës, por edhe qytetarë të denjë për shoqërinë. Lidhja më e ngushtë midis të rriturit dhe të miturit, i shërben këtij të fundit si një mbështetje për të përmirësuar me kohën mangësitë deri diku negative që ia imponon moshja dhe mjedisi, të cilat përthithen shpejt nga nxënësit.

Mësuesi, me statusin e vet të një edukatori të nxënësit dhe me anë të raportit të krijuar me të, i përcjell atij rrjedhimisht energji pozitive dhe bëhet një shembull pozitiv për të. Për më tepër, e bën fëmijën dhe të riun ta respektojë, ama jo duke ia imponuar atë, por duke ia fituar në mënyrë të tërthortë dhe të merituar. Kjo lloj ndjenje që padiskutim është e ndërsjelltë nëse ekzistojnë këto lloj raportesh, ka si fryt të vetin marrëdhënie të shëndosha dhe një institucion që i përmbush objektivat e veta, pra arsimimin dhe edukimin.

Nga ana tjetër ka shumë nga ata që mendojnë se mësuesi duhet të jetë vetëm një figurë e rreptë “shpërndarësi dijesh”. Ky koncept në fakt është si rrjedhojë e sistemit të mëparshëm në vendin tonë, që ka ndikim edhe në jetën sociale të sotme. Funkzioni arsimues i mësuesit, i jep dorë nxënësit të mësojë t’l ndajë marrëdhëniet brenda institucionit të shkollës dhe jashtë tij, e gjithashtu të pozicionojë njerëzit sipas raportit që ka me ta, të afërt dhe të largët. Pra, mësuesi është një person jo i afërt me të, por që ka pasoja pozitive.

Distanca mes këtyre dy palëve sjell një ruatje efikase të privatësisë së cdo individi, ku problemet dhe situatat e ndryshme të jetës së tij private qëndrojnë të fshehura. Nxënësi preferon dhe ndihet më mirë t’l mbajë për vete problemet ose t’i ndajë ato me persona më të afët e jo me mësuesin sepse ai mund të krijojë opinione negative për të apo të ndjejë mëshirë a keqardhje.

Shtojmë këtu edhe faktin, që mësuesi mund të mos jetë në gjendje t'i vijë në ndihmë fëmijës.

Përballë këtyre dy koncepteve kaq të gjerë, nga pozitat e mia shpreh mendimin se gjëja më e mirë do të ishte që shkolla të mund t'i realizonte funksionet e veta edukuese. Në këtë mënyrë do t'i shërbente shumë fëmijës dhe të riut, në vështirësitë e hasura, duke e mirëkuptuar në shumë aspekte si ai personal, arsimor, psikologjik etj. Mësuesi duke qenë në kontakt të përditshëm me moshat e reja është përballur me shqetësime nga më të ndryshmet të tyre dhe është aftësuar për mënyrat e ndryshme të zgjidhjeve, kuptohet deri aty ku mundet dhe ku i lejohet. Personalisht, një mësues i sjellshëm dhe i mirëkuptueshëm rrezaton mirësi dhe meriton të respektohet. Ky është për mua mësuesi ideal, i cili nuk është as i jashtëzakonshëm, as i rëndomtë, por një njeri i respektueshëm.



# Mësuesi im ideal

Unë mësuesi ideal + mësuesi

Mësuesi ideal duhet të jetë shkollë në sytë e nxënësve...

Mësuesi ideal është për mësuesin



Mësuesia është personi: pater në Gjezën e qdo kush udhëheq dhe të arrijtë së dijes!!!

Mësuesi duhet të jetë i shprehur për mësuesin në mënyrë të përcaktuar e detajuar...

Mësuesi duhet të jetë i shprehur për mësuesin në mënyrë të përcaktuar e detajuar...

Panozë Beumilda Abdiqi  
Zëni 16 + ... Elbasan



Punoi:  
**Doris Pepaj**

## Ese për mësuesin ideal

Në ditët e sotme është shtuar edhe numri i nxënësve që sjell si pasojë rritjen e numrit të mësuesve. Gjë e domosdoshme . Por kjo gjë ka anët e mira dhe të keqija . Çdokush e konsideron mësuesin si një prind të dytë, si një person që mundohet ta mësojë dhe edukojë si një fëmijë. Konsiderimi në ditët e sotme është ulur shumë. Kjo gjë për shkak të rritjes së numrit të mësuesve. Të konsiderosh një mësues si prindin tënd të dytë dmth një konsiderim goxha i madh që duhet vlerësuar dhe duhet të jetë privilegj për mësuesit e sotëm. Një mësues, fëmija e sheh në mënyra të ndryshme. Për mua një mësues ideal është njeriu më perfetk që do doja të shihja.

Një mësues ideal dmth një mësues pa gabime sic janë shumica në ditët e sotme. Fakti që në ditët e sotme nuk ka mësues shumë të kualifikuar ul interesin e nxënësit në gjithëpërfshirjen në mësim. Në një farë mënyre mësuesi ka ndikimin e vet në interesin që tregon fëmija për mësimet. Si rrjedhoje e kësaj mendoj se duhet të pakësohet numri i mësuesve dhe si rrjedhoje do të vijë shtimi i një mësuesi ideal, që ndoshta do të ishte ëndrra e të gjithë nxënësve. Kjo gjë do të ketë pëfundimet e veta në të ardhmen dhe ndoshta ato do të jenë pozitive.

Një mësues ideal mund të ketë cdo gjë në dorë, ndoshta edhe të ardhmen e një fëmije ose edhe të të gjithve që menaxhon ajo.



Punoi: **Semi Daka**





Punoi:  
**Alessia Çiftja**  
Zeri 16+ Elbasan

## **365 “7 MARS” në vit!**

Kur flas për një mësues ideal I referohem hapësirës jashtë detyrës së tij të mësimitdhënies. Kur flas për mësuesin ideal, kam parasysh atë mësues që di të menaxhojë më së miri marrëdhënien e tij me nxënësin.

Me këtë nënkuptoj një mësues që është gjithmonë pranë teje për të të ndihmuar për të të këshilluar për të të kuptuar... është gjithënjë një shpatull ku mund të mbështetesh.

Një mësues ideal është ai që mendon për problemin tënd edhe pasi del nga shkolla, ai që të mbështet, qoftë edhe me një buzëqeshje, ai që të korrigjon qoftë edhe me një vështrim sa herë duhet, është ai që nuk të sheh si një tjetër adoleshent problematik, por thjesht përpiqet të kuptojë botën tënde me shumë normalitet.

Ai di të ruajë figurën autoritare edhe kur ka ndërtuar marrëdhënie të ngushta me nxënësit e tij pasi nderimi për këtë mësues është i natyrshëm, konstant dhe nuk mbaron me vitet e shkollës.

***Mësuesi im ideal meriton 365 “7 MARS” në vit!***



**MESUESI IDEAL**

Mësues...nie t'jale qe tingelloj bukur ose me sakre me t'jale qe tingelloj mesoj sikur duam te dimi-hone e dyte

Në mësues ideal nuk do të ishte vetëm ai mësues që shpëton çdo 45 minuta .

Por ai mësues ideal do të na jallo mbështetje për çdo gjë që tomijet kanë nevojë dhe që është e qartshme për të bërë çdo gjë.

Te ishte i mpre për çdo tomije dhe të kujtohej për të si të merrte të vërtetë... AH...po! qeja me lexesore pastaj edhe shpjegimi i mësimit që qe e zbulonon mësuesin ideal atëherë edhe me t'jume .....

**KY DO TË ISHTE MESUESI IM IDEAL !**

pisoi: FR MUKA...zeri 16...ELBASAN

Punoit:  
Klea Xhyra

## Mësueses sime

Siç i kam përherë  
Diellin edhe hënën  
Ashtu i kam në jeë  
Mesuesen time.

Dashuri dhe respekt  
Tu falim në këtë jetë  
Të mos ti harrojmë kurrë  
Derisa të kemi jetë.

Mesuese ideale të kam  
Dhe të kam në zemër  
Gjithmonë do të të thërras  
Vetëm me këtë emër.




Punoi:  
**Xhoana Qosja**  
Zeri 16+ Elbasan

## ‘Mësuesi ideal’

Syte e saj janë pasqyrë...  
Ku shëmbëllimi është mirësia e saj.  
Buzëqeshja e saj është çelës...  
Celësi për zgjidhjen e të gjitha problemeve.  
Fjalët e saj janë yje...  
Yje të cilat të orientojnë në errësi.  
Ledhatimet e saj janë rreze dielli...  
Të ngrohin dhe të lehtësojnë shpirtin .  
Dijen që ka e shpërndan nëpër fara,  
Kujdeset që ato të bëhen pemë.  
Është ajo e cila fillon të shtrojë rrugën,  
Rrugën e gjatë nëpër të cilën do ecim...





Punoi:  
**Ermal Cela**  
Zeri 16+ Elbasan

## Mësuesi ideal

Cdokush nga ne, në të gjithë jetën  
Ka nevoje për mësues të mirë  
Që t`i tregojë të vërtetën  
Dhe të mos ngelet në errësi

Këta mësues të na ndihmojnë  
Gjithmonë pranë të na qëndrojnë  
Këshilla të mira të na dhurojnë  
Dhe jetën tonë ta zbukurojnë.

Si një zambak i bukur uji  
Dituria gjithmonë lulëzon  
Në castet më të vështira  
Zgjidhja e vetme nga ajo buron

Një njeri i mirë dhe i ditur  
nuk trembet nga sfidat e jetës.  
Ai është gjithmonë i përgatitur  
për t`i bërë ballë të vërtetës.

Një mësues ideal diturinë nuk e kursen  
Dhe kohën kurdo për ne gjen.  
Ai kurrë nuk lodhet të punojë  
një brez të ri përpara ta cojë.

Me respekt për mësuesit...



Mauresi ideal. edito ni. te alit ti i  
ded. tam sukse em leand.





Punoi:  
**Ana Oketa**  
14 vjeç  
Zeri 16+ Durrës

## Mësuesi ideal

Profesioni i mësuesit në ditët e sotme konsiderohet si një profesion kalimtar, sa për të marrë një rrogë të mjaftueshme për të jetuar dhe jo një passion i bukur për t`u ndjekur në jetë. Kjo është e gabuar sepse të qëniti mësues do të thotë të kesh brezat e rinj çdo ditë para syve, të kontribuosh në rritjen e tyre dhe të ndërtosh të ardhmen e vendit. Nëse një mësues nuk e merr seriozisht këtë punë atëherë nuk është një mësues i vërtetë. Për të qenë një mësues duhet të kesh përkushtim në punën që bën, por për të qenë një mësues ideal nevojitet më shumë. Frymëzimin për këtë ese e mora nga një shprehje : Mësuesit më të mirë janë ata që të tregojnë ku të shikosh, por jo çfarë të shikosh. Pra mësuesi ideal duhet të të tregojë rrugën drejt zgjidhjes e jo të ta tregojë zgjidhjen.

Një mësues ideal duhet të jetë komprehensiv. Ai duhet ti kuptojë nxënësit nëse kanë probleme dhe në një mënyrë të bëhet bashkëmohatar i tyre. Fantazia është ajo që ka sjellë zhvillimin e botës, ka sjellë shpikjet më të mëdha dhe zgjidhjet e reja për shumë probleme. Prandaj kufizimi i fantazisë së brezit të ri është kufizim i zhvillimit të shoqërisë në të ardhmen. Një mësues mendjehapur e me vizion e ka gjithmonë parasysh këtë gjë. Ky mësues perfekt duhet ta bëjë mësimin sa më argëtues dhe interesant për nxënësit e tij dhe pa përtesë ta shpjegojë sa herë nevojitet. Ai duhet ti bëjë


nxënësit të ndihen mirë edhe kur zgjidhin diçka gabim. Mësuesi është si një prind që mban përdore fëmijën kur mëson të ecë .Ai vetëm e ruan të mos bjerë dhe tenton që fëmija të shkëputet dhe të ecë vetë. Kjo është arritja e një mësuesi.

Ai nuk duhet t'u shpjegojë nxënësve vetëm tekstin, por duhet të kthejë eksperiencat e tij në dije për ta. Nxënësit kështu arrijnë të ndjejnë respekt për të edhe jashtë shkollës. Respekti që ai fiton pastaj është besim i nxënësve tek ai. Ky besim e lehtëson shumë marrëdhënien nxënës-mësues.

Më vjen keq që mësues të tillë janë të rrallë dhe do të doja të mos zhduken.







Punoi:  
**Ivana Idrizaj**  
13 vjeç  
Zeri 16+ Durrës

## Mësuesi ideal!

Të jesh një mesues nuk është e lehtë. Ky profesion kaq human kërkon një punë të vazhdueshme dhe shumë të lodhshme. Mirëpo si çdo gjë tjetër në jetë asgjë nuk është e pamundur, kur dëshira dhe vullneti janë të mëdha. Detyra e mësuesit është një detyrë prej “heroi” sepse në një mënyrë apo tjetër, është një bashkëveprim me jetë shumë të reja njerë zish, të cilat kanë nevojë për ta. Kur flasim për një mësues ideal kam parasysh një mësues që di të menaxhojë më së miri marrëdhëniet e tij me nxënësit. Me këtë nënkuptoj një mësues që është gjithmonë pranë meje për të më ndihmuar, për të më këshilluar dhe mbi te gjitha për të me kuptuar. Ai është mësuesi që përpiket ta kuptojë botën time të brendshme dhe mos t’i dukem thjesht një adoleshent. Mësuesi ideal di ta ruajë figurën e tij autoritare dhe kur ka ndërtuar marrëdhënie të ngushta me nxënësit e tij. Mësuesi ideal nuk është i paarritshëm, ai është më se real dhe gjendet kudo, në çdo shkollë. Është një profesion mjaft i vështirë por jo i porealizueshëm, i lodhshëm si profesion, por shumë emocionues, kur sheh çdo ditë fytyrat e nxënësve, sytë e tyre që flasin me shkëlqimin e tyre.

Një mësues ideal duhet të përdorë metoda të ndryshme mësimdhënie, me qellim që të përfshihen të gjithë nxënësit .


Një mesues duhet te mos beje dallime me nxenesit e tij sepse ne nxenesit jemi shume te ndjeshem dhe prekemi lehte.

Mesuesi duhet te jete i drejte ne gjykimin e tij ndaj nxenesve dhe vleresimit me note. Nje mesues ideal duhet te nxise nxenesit

e tij për të mesuar. Mësuesit tim ideal nuk duhet t'i mungojë buzëqeshja dhe sensi i humorit. Ne jemi qenie të brishta dhe një moment të vështirë e kalojmë më lehtë me një buzëqeshje nga mësuesi.

Për mua mjafton kaq që një mësues të jetë jo vetëm ideal, por një "SUPERHERO". Një mësues i tillë meriton të adhurohet nga nxënësit dhe 7 Marsi i tyre të festohet 365 ditët e vitit.





Punoi:  
**Jurgen Alizoti**  
14 vjeç  
Zeri 16+ Durrës

## Mësuesi ideal

Kur flas për një mësues ideal i referohem hapësirës jashtë detyrës së tij të mësimit. Kur flas për mësuesin ideal, kam parasysh atë mësues që di të menaxhojë më së miri marrëdhënien e tij me nxënësin. Me këtë nënkuptoj një mësues që është gjithmonë pranë teje për të të ndihmuar për të të këshilluar, për të të kuptuar...është gjithnjë një shpatull ku mund të mbështetesh. Një mësues ideal është ai që mendon për problemin tënd edhe pasi del nga shkolla, ai që të mbështet, qoftë edhe me një buzëqeshje, ai që të korrigjon qoftë edhe me një vështrim sa herë duhet, është ai që nuk të sheh si një tjetër adoleshent problematik, por thjesht përpiqet të kuptojë botën tënde me shumë normalitet. Ai di të ruajë figurën autoritare edhe kur ka ndërtuar marrëdhënie të ngushta me nxënësit e tij pasi nderimi për këtë mësues është i natyrshëm, konstant dhe nuk mbaron me vitet e shkollës.

Ti mund ta kuptosh që ai është bërë mësuesi ideal për ty kur rrespekti për të nuk mbaron kur shkolla ka mbaruar. E kupton këtë gjë kur i bën nderimet në çdo ditë feste që ajo ka, nuk ia harron kurrë ditëlindjen, nuk harron t'i bësh një buqetë me lule kur ka 7 Marsin. Çdo gjë ndryshon kur mësuesi të ofron dashuri dhe mirëkuptim gjithashtu edhe ndihmës për çdo problem që mund të hasësh. Por ky mësues nuk ekziston sepse asnjë nuk është perfekt dhe sado i mirë që të jetë mësuesi nuk mund të jetë ashtu siç kërkon çdo nxënës. Nxënësi është ai që e vendos këtë

mësues ideal dhe në qoftë se ky mësues do të ekzistonte, jeta e çdo nxënësi do të ndryshonte përfundimisht rrënjësisht por këtë e shohim që nuk ekziston sepse nuk kemi ndonjë klasë në të gjithë republikën ku nxënësit janë të gjithë me nota të larta. Por në qoftë se do të ekzistonte do të meritonte të gjitha të mirat e botës. Mësuesi im ideal meriton 365 “7MARS” në vit! Biles çdo minut që do të kalonte, asaj ose atij t’i shtohet 1 vit jetë pasi ajo ose ai do ta meritonte.


## Mësuesi ideal

E gjatë 1 e 80  
Me flokët e verdha  
Shpjegon shumë bukur  
Dhe të bën shumë ledha.

Ajo është një idhull  
Është e vetmja që dëshiron  
Kur vjen 7 Marsi  
Dhuratat e botës i meriton.

Sado të flasim  
Dhe çdo mësues të krahasohet  
Të gjithë mund të përpiqen  
Por asnjë nuk i afrohet.

Një mësues ideal  
Nuk është asnjë  
Por po të ishte gjallë  
Jetën parajsë do të na kishin bërë





## Mësuesi ideal


Mësuesi ideal është ai mësues i cili na ndihmon të hapim dyer të reja në jetën tonë, na ndihmon të mësojmë gjëra të reja e të bëhemi të ditur.

Mësuesi ideal duhet të di si të sillet me nxënësit. Ta zhvillojë orën e mësimit në menyra të ndryshme që nxënësit ta kenë vëmendjen.

Mësuesi ideal duhet të sillet mirë me nxënësit, t'i ndihmojë ata. Ai duhet ta shpjegojë në mënyrë të kuptueshme mësimin.

Mësuesi ideal nuk duhet të jetë nga ata mësues që i marrin inat nxënësit, ai duhet të mos mbajë me hatër asnjë prej tyre, të mos vendosi nota që nxënësit nuk i meritojnë (edhe në raste kur notat janë të këqija por edhe në raste kur notat janë të mira). Nëse mësuesi i ka këto cilësi atëherë ai do të fitojë dashurinë dhe respektin e nxënësve. Nxënësit do ta kujtojnë atë dhe ai do t'i kujtojë nxënësit. Nëse një mësues sillet keq me nxënësit atëherë ai do të fitojë urrejtjen e tyre. Asnjë nga mësuesit nuk e do urrejtjen e fëmijëve, por dashuria e tyre nuk është kaq e lehtë për ta fituar.





## Mësuesi ideal

Perceptimi im i një mësuesi ideal është të qenit një qenie i/e mirë, njerëzore, i mëshirshëm, falës, i sjellshëm, interesant, zbavitës, i dashur dhe dikush, i cili do të na jepte njohuri të reja dhe mund të bëjë mësimin interesant.

Të qenit mësues është konsideruar të jetë një profesion fisnik, por sot njerëzit zgjedhin këtë profesion pa u menduar mirë sepse shumë persona nuk e dinë se të jesh një mësues do të thotë të përkushtohesh me mish e me shpirt për të mësuar brezat e rinj.

Ka shumë mësues, por nuk do të ishte gabim të themi se shumë pak kanë njohuri të bëhen të tillë, te shumtë janë ata që janë në këtë profesion më shumë për hir të të fituarit para dhe jo për të hedhur bazat e një të ardhmeje të sigurt për vendin ku ata jetojnë. Ata janë më pak të shqetësuar për nxënësit dhe janë më të interesuar në kryerjen e punës së tyre rutinë. Ata nuk kanë njohuritë e duhura për të zgjidhur problemet e nxënësve dhe për t'i kuptuar ato. Unë mendoj se individë të tillë, kurrë nuk duhet të bëhen mësues.

Një mësues ideal është ai që i kupton nxënësit dhe njekohesisht i pasuron ato me dije të reja.

Ai duhet të jetë i informuar se, të dhënit mësim nuk është kurrë e thjeshtë sepse në ditët e sotme kemi shumë nxënës që nuk parapëlqejnë të vazhdojnë shkollën e tyre, por preferojnë që te

ndjekin nje rrugë e cila nuk eshte e pershtatshme per to, per shkak te kesaj arsyeje mesuesi duhet ta beje mesimin sa me interesant dhe te pelqyeshem nga nxënësit ne menyre qe ky fenomen te zhduket.....

Një mësues ideal është një aktor i mire i cili mund të vë eksperiencen e jetes se tij ne ndihme te nxënësve. Nxënësit duan të jenë në klasë me zgjedhje dhe jo me forcë.

Mësuesi duhet të ketë një sens të mirë të humorit, duhet te jete i kuptueshem dhe gjithashtu duhet edhe të qeshë me nxënësit sepse vetem ne kete menyre nxënësit do ta kuptojne se mesuesi eshte nje mik i mirë per to. Ai nuk duhet te zemërohet me lehtësi por duhet te jete i gezuar dhe krenar qe eshte duke edukuar brezin e ardhshem....

Ai duhet te jete si një mik në të cilin nxënësit mund të besojne lehtë pa frikë e pa u tallur apo kritikuar nga te tjeret.


Një mësues ideal duhet te jete i ndjeshem dhe falës. Ai gjithmonë duhet te kete kohë për të zgjidhur problemet e nxënësve, kurrë nuk duhet te humbasi durimin e tij me ta por duhet te jetë i sinqertë, i disiplinuar, i thjeshtë dhe i përvullor. Ai kurrë nuk duhet te mburret me atë që ai e di dhe nuk duhet te përpiqet për të provuar se ai është” Perëndi” dhe di gjithçka.

Mesuesi duhet te jete i gatshëm të pranojë gabimet e tij dhe nuk duhet te hezitoje për të kërkuar falje,..

Kështu, një mësues me cilësitë e mësipërme është mësuesi im ideal, dhe unë do ta dua atë, sepse ai më ka mësuar që të jem një genie njerëzore e mirë, dhe me ka inspiruar mua për të pranuar të gjitha sfidat e jetës me kurajo. Ai më ka mësuar vlerën e punës së vështirë, ndershmërinë dhe mirësjelljen.

Për keto arsye unë ndihem krenar se si jam ndërtuar, por këtë ia dedikoj atij, mesuesit tim të dashur.





Punoi:  
**Claudia Buci**  
Zeri 16+

## Mësuesi ideal

Një mësues ideal duhet të ketë shumë kualitete. Efekti i personalitetit të tij mbi nxënësit zgjat gjatë.

Një mësues ideal është ai i cili është i dashur dhe i respektuar nga çdo nxënës. Ai duhet të përpiqet të krijojë një lloj marrëdhënie të mirë në lidhje me zemren dhe mendjen e nxënësit.

Një mësues ideal duhet të jetë një dijetar. Ai duhet të ketë njohuri të subjektit që ai mëson në klasë. Ai duhet tua mësojë lëndën në një mënyrë interesante, që nxënësit të jenë të interesuar me të vërtetë në lëndën që ai u jep.

Një mësues ideal duhet të shprehet mirë, duhet të ketë një zë të mirë dhe duhet të ketë dashuri për mësimdhënie. Nxënësit duhet të mendojnë se mendjet e tyre janë në rritje në mësimin e tij. Ai jo vetëm që kalon informacion për ta, por edhe zhvillon dashurinë për të mësuarit. Ai aktivizon mendjet e studentëve të tij, u mëson atyre se si të mendojnë dhe të rrisin fuqinë logjike. Ai duhet të jetë një njeri i ideve, duhet ti shpjegojë gjërat në një mënyrë shkencore dhe interesante.

Një mësues ideal është ideal në të gjitha aspektet. Ai nuk përdor fjalët e tekstit por fjalë të thjeshta në mënyrë që nxënësit ta kuptojnë sa më mirë informacionin që ai u jep. Gjuha e tij duhet të jetë e qartë, e lehtë dhe e thjeshtë.

Një mësues ideal duhet të jetë një njeri i kulturës. Nxënësit nuk e pëlqejnë një mësues mospërfillës dhe të ashpër. Ata adhurojnë


mësuesit të cilët gjithmonë mbeten të paanshëm dhe trajtojnë të gjithë studentët e tyre njësoj. Nëse bëhet fjalë për një mësues ideal këto janë karakteristikat që duhet të ketë ai për të fituar dashurinë, vëmendjen dhe respektin nga nxënësi.

## Poezi

Mësuesin ideal e duam,  
Dashurin vëmendjen dhe respektin,  
T'ia dhurojmë dhe kurr' të mos e harrojmë,  
T'i jemi mirënjohës për gjithcka që na dha,  
Dhe ta vlerësojmë, ashtu si dëshiron,  
Çdo dijetar...

Punoj:  
**Claudia Buci**  
Zeri 16+





## Mësuesi im ideal

Të qenurit mësues është një nga profesionet më të bukura, por edhe nga ato që kërkon më shumë përgjegjësi. Është dicka e bukur të japësh dije, por kërkon përgjegjësi sepse merr pjesë në mënyrë direkte në formimin e të rinjve.

Jemi mësuar që mësuesin ta shohim vetëm nga aspekti i mësimdhënies. Sipas kësaj teorie një mësues i mirë është ai që jep dije pa u kursyer.

Me kalimin e kohës dhe me evolimin e shoqërisë shqiptare kjo ka ndryshuar. Sot më shumë se kurrë na nevojiten modele sjelljeje, shembuj për ti pasur heronj. Ky do të ishte një mësues ideal.

Ajo cka pres unë nga ky mësues nuk janë gjëra fantastike apo surreal, nuk kërkoj një gjeni apo një shkencetar, kërkoj një njeri me dije, por mbi të gjitha me vlera.


Kërkoj një mësues që nuk e ka problem t'i kthehet disa herë asaj që shpjegon, që nuk ka turp të pranojë gabimet e tij, një mësues që të më bëjë ta dashuroj lëndën.

Nga ana tjetër kërkoj një mësues që të dijë të japë vlerën e jetës. Jo të gjithë mund të bëhemi dikush në jetë, por të gjithë duhet të jemi njerëzorë.

Duhet të na mësoje c'është falja, gabimi, pendesa, dashuria për veten, për shokët, për atdheun.

Këtë kërkoj nga ky mësues. Pres që ai të jete aty me këshillat e tij kur unë të kem nevojë, pres të ndjej përkujdesjen e tij ndaj meje.

Për mua ky është mësuesi im ideal, një njeri i zakonshëm por me cilësi të mëdha.





Punoi:  
**Artenisa Sanço**  
Zeri 16+ Elbasan

## Mësuesi im ideal

Mësuesi dhe nxënësi janë dy identitete sociale të ndryshme. Kjo do të thotë që kanë mendimin e tyre për njëri tjetrin. Në cdo kuptim që ta shikojmë shkollën ajo është e do të jetë një institucion i madh jo vetëm pedagogjik, por edhe i marrdhënieve të demokratizuara midis mësuesit dhe nxënësit.

Por si janë relatat nxënës mësues?...

Mësuesi është model për nxënësin...

Një mësues model vlerësohet nga nxënësit kur ai nuk shkon në asnjë orë mesimi i papërgatitur, kur përpiqet dhe arrin të kuptojë e të njohë vecoritë psikologjike moshore të nxënësve të tij dhe me buzëqeshjen efektive të përcjellë mesazhin “mos ki frikë nga unë, unë jam këtu për të të ndihmuar”. Mësuesi model ka integritet moral, njerëzor, seriozitetin në perditshmërinë e tij, përgatitjen profesionale dhe **KORREKTESINË**.

Imazhi i mësuesit të pagabueshëm dhe të paprekshëm ndikon negativisht.

Nxënësit janë shpesh shumë intuitive. Ata mund të shprehin më mirë mendimet e tyre nëse u qëndron afër dhe komunikon me ta. Kështu ata tregohen më të sinqertë dhe më të sjellshëm... Por nëse mësuesi mundohet të përdorë të gjitha format e poshtërimit të figures së nxënësit, është e sigurtë që kurrë nuk do të ekzistojë fjala “Mirëkuptim” mes tyre.

Nuk do të angazhohen në detyra dhe do injorojnë orën e mësimit, duke menduar se po veprojnë mirë... fatkeqësisht ky veprim është një dështim nga ana e të dyja palëve. Atmosfera në klasë nuk do të ishte e pëlqyeshme dhe sytë e nxënësve do ishin të drejtuar vetëm tek akrepat e orës duke pritur me ankth dhe gëzim në të njejtën kohë minutat e fundit të orës së mësimit të dështuar.

Të jesh mësues është një profesion sa i bukur dhe i vështirë... Figura e tij rrezaton inteligjencë dhe aftësi komunikimi. Por kjo punë e shenjtë kërkon përkushtim dhe bashkëpunim. Prandaj dhe nxënësi duhet të luajë rolin e tij. Në sytë e cdo gjimnazisti gjendet imazhi i mësuesit ideal.

Dhe në sytë e mi...

Tanimë e kam akoma më të qartë figurën e mësuesit ideal.

Pasi shkruaja dhe mendoja se në të ardhmen do di t'i përballoj më së miri surprizat që do të më servirë jeta, duke pasur virtytet, durimin dhe optimizmin e mësuesit që unë e përkufizojë vetem me një fjalë, "PERFEKT"...

## MËSUESI IDEAL

Një mik  
Një shembull

Ai që të bën të dallosh të mirën nga e keqja.

Ai që të bën dikushi në jetë.

Ai që nuk të thotë kurrë dorëzohu.

Ai që të shtyn të vazhdosh përpara.

Dikush që të kupton.

Dikush që ve veten e tij në vendin tënd.

**Mateo Bori**  
Zëri 16+



Punoi:  
**Devi Delimeta**  
Zeri 16+ Elbasan

## Mësuesi im ideal

Mësuesi im ideal  
është dija mbi valë  
Cdo ditë vjen e qeshur  
tek sa mua më gjen të heshtur  
Më afrohet më shpjegon  
shpirin tim e qetëson

Mësuesja më këshillon  
ato këshilla unë kurrë nuk do ti harroj  
Ti mësuese qëndron gjithmonë pranë meje  
unë kam mësuar shumë prej teje  
Ti hap një derë shkolle  
dhe ndalon një burgosje

Vitet do të kalojnë dalëngadalë  
dhe unë nga bangat e shkollës një ditë do të dal  
Por mësuesja ime punën do të vazhdoj  
ndaj 7 Marsin populli për të e krijoi

O mësuese je prind i dytë për mua  
dija që më dhe kurrë nuk u harrua.



Punoi:  
**Kejsi Çota**  
Zeri 16+ Elbasan

## Mësuesi im ideal

Më parë në fëmijëri, e dija se një ditë do të duhet të shkoja në shkollë. Të gjithë e bëjnë dhe kështu dhe unë një ditë do të kisha çantën time me ato pak libra, që për mua rëndonin sa dijet e botës. E dija që do të shkoja dhe unë në shkollë, sepse të gjithë të rriturit shkojnë atje për t'u bërë më të rritur. Me ato perceptimet e mia feminare e imagjinoja kalimin nga shkolla në shkollë si ato shkallët të cilat ishin të larta deri në re dhe nëpër filma të animuar personazhet i ngjasinin me aq lehtësi, si me shpejtësinë e frymëmarrjes. Shkolla ishte një shkallë. Në fakt të tjerë ishin shkallët me të cilët do të duhej t'u bashkangjiteshe për t'u ngritur atje ku doje. Këto ishin mësuesit. E vallë do të jemi mirë ne pa ta? Vështirë se...!


Përgjate viteve, përpos sfidave që ceknin gjykimet e mia, fillova të përzgjidhja. Po, fillova të përzgjidhja mësues e t'i bëja pjesë timen. Vërtetë është e vështirë të koleksionosh njerëz e i struk si kukulla të dashura ndjenjat që të falin këto të "seleksionuarit".

Mësuesi për mua duhet të jetë që me të hyrë në klasë, të mbyllë perdet e të na japë botën në një dorë, pavarësisht vështirësisë që mund të përmbajë lënda e tij. Ai duhet t'i japë tërë universit kuptim nëpërmjet lëndës që shpjegon. Fjalët që thotë ai, të të sintetizohen në mendje, të gjejë ekranizim tërë gjuha që ai/ajo përdor. Dua të më bëjë ta dua me shpirt lëndën që na mëson pasi vetëm kështu mund



t'i dua të dyja, edhe mësuesin edhe lëndën. Mbi të gjitha nuk dua të jetë i/e butë. Dua të jetë dorështrënguar në vlerësim, të më bëjë të kuptoj se ku unë vërtetë jam. Edhe nëse une ndodhem mes lotësh, të më kuptojë drejt se përse unë vërtet mërzitem. Elokuenca dhe zhdërvjelltësia e një mësuesi dua të vijmë si erë tek unë dhe të zënë vend. Unë e dua të jetë një njeri që shpirtin e fal brenda një klase, që shkruan tërë vështirësinë e lëndës në një mësim të vlefshëm, një njeri që nuk zgjatet tej mase, nuk thur lavde të tepërta, por të mëson se gjërat duhen vlerësuar për atë që duhet dhe jo për atë që dua unë apo çdokush prej nesh. Njëkohësisht unë dua ta kem mësuesin, mik. Një mik që më kupton drejt sapo më sheh në sy dhe nuk gjen përlligje të kota për të më thënë se sa duhet të arrij unë dhe se ku jam unë, apo çfarë duhet të bëj unë. Mjafton këtë të ma thotë me shenja, me veprime, me sy. Mësuesi që dua më shumë nuk është bërtitës, nuk të detyron të mbyllësh librin dhe të dëgjosh atë për 45 minuta, nuk është as ai/ajo që e le klasën të përçarret pasi preferon rehatinë e karriges apo bisedat telefonike. Është mësues ai që megjithëse e ke mësim shqeto përpara syve të tu, ta shëtit mendjen me fjalët e tij/saj, të bën të duket çdo gjë e mësuar prej kohësh, sikur ke gjetur një diamant të hedhur përtokë dhe e mban në gishta, në duar.

Një mësues është ai që fizikën e bën art dhe artin e bën të ecë në binarët e shkencës. Një mësues që dua shumë është ai që më bën të vij me dëshirën më të madhe në shkollë edhe pse nuk kam mësim me të. Një mësues së pari është një njeri.



Punoi:  
**Marinela Buzo**  
Zeri 16+ Elbasan

## Mësuesi im ideal

Thuhet se e ardhmja e një vendi merr formë nëpër shkollat e atij vendi.

Kur bëhet fjalë për të ardhmen, cdo kush i ka sytë nga brezi i ri. Që e ardhmja të jetë sa më e ndritur, fëmijët e të rinjtë duhet të mësohen dhe të edukohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Edukimi dhe mësimi i fëmijëve e të rinjve bëhet në shkolla nga mësuesit. E thënë ndryshe, janë pikërisht mësuesit ata që i japin formë të ardhmes së vendit të tyre.

Roli i mësuesit është vital për një nxënës. Përmbushja e këtij roli në mënyrën e duhur, e bën mësuesin ideal. Por si mund të quhet i përmbushur në mënyrën e duhur roli i një mësuesi, duke e bërë këtë të fundit ideal në sytë e nxënësve?

Së pari, unë mendoj se gjëja thelbësore për një mësues, është njohuria e tij e plotë mbi lëndën të cilën mëson. Më pas vjen aftësia e tij për të përcjellë njohuritë tek nxënësi. Mënyra e shpjegimit, e bën si mësuesin, ashtu edhe lëndën më të pëlqyeshme. Shumë e rëndësishme gjatë procesit mësimor, është aftësia e mësuesit për të kuptuar psikologjinë e cdo nxënësi e për t'iu përshtatur asaj.

Krahas kësaj, vjen aftësia për të kuptuar pikat e forta të nxënësit, talentin e tij dhe aftësia për të dhënë motivim, aty ku motivimi mungon.


Të gjitha këto krijojnë një marrëdhënie mësues-nxënës të karakterizuar nga mirëkuptimi dhe respekti reciprok.

Vitet e para, më të rëndësishme në formësimin e karakterit

të njeriut, kalohen në shkollë dhe roli i mësuesit është tejet i rëndësishëm në formimin e karakterit të çdokujt.

Një mësues ideal jo vetëm do të mësonte dhe edukonte, por do të ishte një shembull për t'u ndjekur në sytë e nxënësve.





Punoi:  
**Ronelda Kullolli**  
Zeri 16+ Elbasan

## Mësuesja ime.

Për një nxënës figura e mësuesit është aq e rëndësishme sa që vjen një moment kur ajo kthehet në jetike.

Një pjesë të madhe të kohës nxënësit e kalojnë në shkollë dhe cdo gjë që ndodh aty ngulitet në memorjen e tyre.

Gjithcka fillon nga ai person që qëndron para tyre cdo ditë.

Mendimi për mësuesin ideal nis që nga sjellja e tij; në vend të të bërtiturave e shprehjeve të përditshme, për nxënësin do të ishte dicka më e bukur, nëse mësuesit do të ishin mbështetësit e tyre.

Mësues ideal do të ishte ai mësues që mundohet të jetë sa më i drejtë në vlerësimin e nxënësit, sepse mësuesit thuhet nuk e kanë idenë e efektit dhe vlerës së notës tek nxënësi.

Nxënësit janë lodhur me figurën e mësuesit që më shumë se sa këshillues, edukues dhe i afërm, ngjan me një xhandar.

Ka ardhur koha që mësuesi ideal të mos jetë vetëm një imazh.

Për ta arritur këtë, nevojitet një njeri, që tek nxënësi shikon karakteristikat e moshës, të jetë një njeri që i inkurajon nxënësit të ecin përpara, një njeri që di të krenohet me shkujdesjen dhe spontanitetin e tyre, por mbi të gjitha një njeri i sinqertë dhe transparent.

Gjithsesi këto mësues janë shumë të paktë!!!



Punoi:  
**Denisa Kasa**  
13 vjeç  
Durrës

## Mësuesi ideal


Më duket pak temë e vështirë pasi më kërkohet të përshkruaj një person të cilin nuk e njoh. Një person i cili egziston vetëm në mendjen time. Ja sesi e mendoj unë mësuesin ideal:

Një mësues i cili nuk jep mësim vetëm sepse e ka për profesion, por jep mësim që brezi i ri të jetë më i ditur, që këto nxënës që ai po edukon në të ardhmen të bëhen dikush në jetë. Ky mësues duhet të bëhet një figurë e dashur dhe familiare për nxënësin. Pra nxënësi të gjejë qetësinë tek ky person dhe jo frikën.

Një mësues që do të jetë gjithmonë aty me nxënësin e tij për ta ngushëlluar në momente të vështira dhe për ta qortuar kur nxënësi gabon.

Mësuesi në fjalë nuk duhet të përdori kurrësesi dhunën fizike ose psikologjike sepse ndyshe nuk do të mund të quhej mësues ideal. Por do të quhej një mësues i zakonshëm nga mësuesit me të cilët mund të ndeshemi çdo ditë në shkollat tona.

Nuk mund të kërkoj një mësues perfekt pasi një i tillë nuk mund të gjendet në mbarë rruzullin tokësor sepse askush nuk mund të jetë perfekt. Nëse unë do të kisha një mësues të tillë ai do të mbetej gjithmonë në dosjen e kujtimeve të mia më të bukura!



Punoi:  
**Çezarina Rusi**  
14 vjeç  
Durrës

## Mësuesi ideal

Arsimi është shumë i rëndësishëm në rrugët e jetës sonë. Përveç librave që na japin dije rëndësi më shumë kanë ato që na i transmetojnë këto dituri, mësuesit.

Një mësues ideal përpara syve dhe mendjes tonë është ai njeri që na bën ta shikojmë drejt në sy për të kuptuar qëllimin dhe prezencën e tij në klasë. Gjithashtu një nxënës i mirë dhe një karakter i fortë i njeriut krijohet brënda ambjentit shkollor. Shoqëria zë pjesën më të rëndësishme gjithashtu në formimin intelektual të njeriut, ndaj dhe një mësues ideal duhet të jetë një shoqeri e mirë për ne. Një njeri i qetë, i dashur, shumë i komunikueshëm, i duruar dhe i sinqertë në çdo bisedë me ne mund të përfaqësojë një mësues ideal.

Gjatë këtyre viteve shkollore gati gjysmën e ditës e kalojmë me mësuesin tonë ndaj ai konsiderohet më shumë se një mësues për ne. Por jo të gjithë mësuesit janë ideal. Shumë mësues janë ndryshe idealit që mendoj unë por edhe ata mundohen të arrijnë idealin. Besoj se komunikimi i sinqertë brënda ambjenteve shkollore me mësuesin tonë është kryesore për një mendje të shëndoshë.

Njerëzit nuk janë perfekt dhe asgjë nuk është ideale nëse nuk mundohemi të kuptojmë njëri-tjetrin. Punën më të rëndësishme e kanë mësuesit të cilët duhet të përshtaten me mendimet dhe ndjenjat tona për shkak të diferencës së moshës por ideali që shohim ne tek ta është në duart e tyre ashtu siç na ndihmuan në klasë të parë për të mësuar shkronjat e para në fletët e bardha të fletoreve dhe deri sot për të shkruar për ta, mësuesit tanë idealë...

Edukim

Zhvillim



Mbështetje

Argëtim

IEV9 lezhë

Lokol Çola

Uhpjegu mijest mirë mësuesin.

Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.

Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.

# Mësuesi im Ideal

Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.

Di t'i japë  
mësimet e tij  
atë ku duhet.

Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.

Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.  
Uhpjegu mijest mirë mësuesin.

Pamë: Jylli Mujëri  
"Zotit i" Etonem.



## Save the Children

Rr. "Komuna e Parisit", Lagjia 8,  
Pallatet 1 Maji, Vila "Lami", Albania  
P.O. Box 8185  
Tel: +355 4 2261840 /  
+355 4 2261929 /  
+355 4 2266227  
Fax: +355 4 2263 428  
E-mail: info.albania@savethechildren.org  
Web Page: <http://albania.savethechildren.net>